

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



11-17 GUSHT JAVA E MBROJTJES



FA NË VIJËN E PARË KUNDËR ZJARREVE

Edhe gjatë kësaj jave, efektivet e Forcave të Armatosura janë angazhuar intensivisht në operacionet për shuarjen e zjarreve, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat e Emergjencave Civile. Mbi 1.200 forca operacionale kanë vepruar në terren, të mbështetura nga 6 helikopterë dhe avion të ardhur në ndihmë në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian. Ndërkohë, bashkitë po vijnë me përllogaritjen e dëmeve për të mundësuar kompensimin përmes Fondit për Mbrojtjen Civile.

★★★★★

JM



XHENIERËT E NATO-S STËRVITEN NË LETONI

Xhenierë nga Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Franca, Italia dhe Spanja po marrin pjesë në një stërvitje të përbashkët në Letoni, ku po zhvillojnë aftësi në shpërthime taktike, ndërtim pengesash dhe pastrim minash në kuadër të misionit.

JM





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES



“LISSUS” SHPËTON 25 JETË NË EGJE

Anija “LISSUS” P-133, me mision në detin Egje, shpëtoi 25 emigrantë (afganë dhe sirianë), përfshirë gra dhe fëmijë, në bashkëpunim me Rojen Bregdetare Turke. Operacioni u krye me sukses gjatë një patrullimi rutinë, duke dëshmuar angazhimin e Forcës Detare për sigurinë në det dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

JM




mod.gov.al

FORCAT XHENIERE ASGJËSOJNË MUNICIONE NË TEPELENË

Ekipe të Batalionit të Xhenios u angazhuan në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Tepelenë. Në fshatrat Peshtan dhe Mezghoran, ekspertët asgjësuan në vend municione të rrezikshme dhe të patransportueshme, duke zbatuar rregullat e sigurisë për mbrojtjen e jetës dhe mjedisit.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

SHQIPËRI-BRITANI E MADHE FORCOJNË BASHKËPUNIMIN USHTARAK

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletenant Arben Kingji, priti në takim atasheun e ri ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, N/Kolonel David Strong. Gjatë bisedimeve u theksua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë në fushën e mbrojtjes. Palët ranë dakord për thellimin e partneritetit strategjik përmes zhvillimit të kapaciteteve ushtarake dhe rritjes së shkëmbimeve dypalëshe mes dy vendeve.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

SHQIPËRIA, E FTUARA E NDERIT NË “PÉRIGORD NOIR”

Në edicionin e 43-të të Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës Klasike “Périgord Noir” në Francë, Shqipëria ishte vendi i ftuar i nderit. Kuarteti TOGHA i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura dhe mezzosopranoja kosovare Flaka Goranci sollën një program tërësisht shqiptar, me melodi nga të gjitha trevat. Performanca u prit me entuziazëm.

★★★★★

mod.gov.al

JM